

## **NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Fillim Skoro, kryetar, Xhevdet Abazi dhe Tonka Berishaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarës V.J. nga Parteshi, për shkak të veprës penale, keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore – DKR në Gjilan, PKR.nr.194/15, të datës 09.10.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të KPPK, më datë 14.12.2017, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore - DKR në Gjilan, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore - DKR në Gjilan, PKR.nr.194/15, të datës 09.10.2017, vërtetohet.

## **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore - DKR në Gjilan, me aktgjykimin PKR.nr.194/15, të datës 09.10.2017, të akuzuarën V.J. nga Parteshi, bazuar në dispozitat e nenit 364 par.1 nën par.3 të KPPK, e ka liruar nga akuza për veprën penale keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo i autorizimit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPK-së, me arsyetim se me provat e procedura në shqyrtimin gjyqësor nuk është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarës përmbushën elementet e veprës penale në fjalë. Për shpenzimet e procedurës penale ka vendosur që të mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Të dëmtuarit B.S.,P.S.,A.S.,S.M.,G.K.,A.M.,Z.S.,D.S. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike i ka udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur Prokuroria Themelore - DKR në Gjilan, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës, seancën e kolegjit e caktoi konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK-së, për të cilën nuk janë njoftuar fare palët pasi që në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me aktgjykim ku është shqiptuar dënimi me burgim, prandaj, njoftimi i palëve nuk është i obligueshëm.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA/I.nr.495/17, të dt. 15.11.2017, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, të aprovohet dhe aktgjykimi i shkallës së parë, të anulohet ndërsa çështja të kthehet në rivendosje.

Gjykata e Apelit, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje penalo-juridike, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Pretendimet ankimore përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjetjet e gjykatës.

Prokuroria Themelore – DKR në Gjilan, në ankesë pretendon se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 12 e lidhur me nenin 370 të KPK-së, ngase, dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është në kundërshtim të plotë me provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe atë sidomos me deklaratat e të dëmtuarve- dëshmitarëve, ku shumica prej tyre vërtetojnë se kanë qenë të detyruar që pagën e tyre ta ndajnë me persona të tjerë, ndërsa, gjykata e shkallës së parë, edhe përkundër deklaratave në fjalë e liron të akuzuarin, me konstatim se me provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar se e akuzuara ka kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPK-së, për çka, konsideron se me këtë, gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 12. të KPK-së.

Gjykata e Apelit, gjen se nuk qëndrojnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cekura si më lartë, por as që ka shkelje të tjera të cilat kjo gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare, e që kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të shkallës së parë.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par.12 të KPPK-së, ngase aktgjykimi i ankimuar duke përfshirë edhe arsyetimin, është i qartë dhe konkret, po ashtu përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante në këtë çështje penalo-juridike dhe gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar të gjitha faktet vendimtare dhe atë qasja ndaj fakteve vendimtare përveç që ka qenë e drejtë, objektive dhe e ligjshme, po ashtu ka mbështetje edhe në provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor, prandaj nuk qëndron pretendimi ankimor se të

njëjtat nuk kanë mbështetje në provat e proceduara në seancën gjyqësore. Kështu, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, vlerësimin e saj e ka bazuar së pari në mbrojtjen e të akuzuarës, e cila nuk i konteston faktet dhe rrethanat përkitazi me vendin e punës-pra, se ka punuar Drejtoreshë e Arsimit për Komunën e Parteshit, se e njëjta gjatë pranimit në punë të dëmtuarve ka respektuar dispozitat procedurale për pranim, gjegjësisht kjo është bërë nga ana e komisioneve për pranim në marrëdhënie pune, pastaj, e njëjta ka nënshkruar kontratat për marrëdhënie pune me të dëmtuarit në bazë të vendimit të komisionit për pranim në marrëdhënie pune dhe se të dëmtuarve u janë bërë pagesat në bazë të kontratës dhe përmes procedurave bankare dhe se me asnjë nga provat materiale por as deklaratat e dëshmitarëve – të dëmtuarve nuk vërtetohet se e akuzuara i ka detyruar të dëmtuarit që të ndajnë para në shuma të caktuara për persona tjerë, gjegjësisht, të dëmtuarit, sikur që konstatohet në aktakuzë, por edhe tani në ankesë. Po ashtu, faktet dhe rrethanat në fjalë, gjykata e shkallës së parë, i ka vërtetuar edhe nga të dëmtuarit, ku shumica prej tyre nuk i kontestojnë faktet dhe rrethanat se nga pagat e tyre kanë ndarë shuma të caktuara të parave për kolegët e tyre që kanë mbetur pa punë, mirëpo, këtë e ka bërë kryesisht në baza vullnetare, kurse, disa nga të dëmtuarit që deklarojnë të kundërtën, përkitazi me këtë gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme, pse nuk iu ka falur besimin deklaratave të tyre, konkludime këto të cilat i aprovon edhe kjo gjykatë, prandaj, nuk qëndron pretendimi ankimor se konkludimet e gjykatës së shkallës së parë, nuk kanë mbështetje në provat dhe shkresat tjera në lëndë. Prandaj konstatimi se me provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor nuk është vërtetuar se e akuzuara ka ndërmarr ndonjë veprim inkriminues në drejtim të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPK-së, është i ligjshëm dhe i drejtë, për çka më në detaje përkitazi me këtë do të bëhet fjalë gjatë elaborimit të pretendimeve ankimore edhe përkitazi me gjendjen faktike.

Pretendimet ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe gjetjet e gjykatës.

Përkitazi me bazën ankimore vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike nga Prokuroria Themelore, kontestohet mënyra se si janë vlerësuar provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor nga ana e gjykatës së shkallës së parë, e duke pretenduar kështu se edhe konkludimet e asaj gjykate të nxjerra në bazë të këtyre provave janë të gabuara. Pretendohet se provat në fjalë janë vlerësuar në mënyrë të njëanshme dhe të gabuara dhe se si pasoj e konkludimeve të aprovuara ka rezultuar me shkelje të Ligjit Penal në favor të akuzuarës, për çka gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka vepruar kur vendimin e ka marrë, duke mos marrë parasysh deklaratat e të dëmtuarve – dëshmitarëve, pastaj dëftesat e nënshkruara nga të dëmtuarit dhe personat të cilët kanë pranuar shumën e parave për çdo muaj nga të dëmtuarit, pra, kur janë marrë pagat, e të gjitha këto, i kanë bërë sipas urdhrit të akuzuarës, kuptohet kur i kanë nënshkruar kontratat e punës.

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet ankimore të cekura si më lartë, nuk qëndrojnë, ngase gjykata e shkallës së parë, provat e proceduara i ka vlerësuar me përputhje me dispozitat e nenit 361 të KPPK-së, kështu që drejt i ka vlerësuar dhe analizuar faktet vendimtare, përkitazi me këtë në këtë çështje penale–juridike në mënyrë të pa dyshimtë ka vërtetuar gjendjen faktike në bazë të së cilës edhe e ka liruar të akuzuarën nga akuza, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo i autorizimit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPK-së.

Në rastin konkret me provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor në mënyrë të pa kontestuar gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar se e akuzuara si drejtoreshë në cilësinë e drejtoreshës së Departamentit për Arsim dhe Kulturë në Komunën e Parteshit, ka nënshkruar kontrata të punës, me 76 arsimtarë të nacionalitetit serb, të cilët kanë kaluar nga Sistemi Paralel i Arsimit të Serbisë, në Sistemin Arsimor të Kosovës, kuptohet, pasi më parë përkitazi me këtë kanë vendosur komisionet kompetente në bazë të konkursit të rregullt për pranim në marrëdhënie pune. Po ashtu, në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar se nga gjithsej 220 arsimtar që kanë punuar në sistemin paralel të Serbisë, në marrëdhënie pune në Sistemin Arsimor të Kosovës, janë pranuar vetëm 76 prej tyre, ku një numër i caktuar i tyre, pra, i personave që kanë mbetur pa punë janë ndihmuar në forma të ndryshme për çdo muaj nga arsimtarët të cilët kanë marrë paga të dyfishta, pra, edhe në Sistemin Arsimor Paralel të Serbisë edhe nga Sistemi Arsimor i Kosovës. Po ashtu, në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar se të gjithë të dëmtuarit – arsimtarët që kanë punuar në Sistemin Paralel të Serbisë dhe atë të Kosovës, kanë marrë paga të dyfishta, për çka, të njëjtit janë dakorduar me arsimtarët që kanë mbetur pa punë, që çdo muaj, gjatë marrjes së pagës një shumë të caktuar t'ua japin arsimtarëve që kanë mbetur pa punë. Mirëpo, sipas dëshmitarëve por edhe provave materiale në shkresat të lëndës nuk vërtetohet se të dëmtuarit këtë e kanë bërë përmes llogarisë bankare apo në forma të ndryshme, duke ua ndalur shumën e caktuar të parave nga ana e Departamentit për Arsim dhe Kulturë, gjegjësisht, Drejtoresha e Departamentit për Arsim dhe Kulturë-tani e akuzuara V.J., pra, sipas vetë deklaratave të dëmtuarve, këtë të dëmtuarit e kanë bërë personalisht duke u dhënë para në shuma të caktuara personave tjerë – arsimtarëve që kanë mbetur jashtë sistemit arsimor të Kosovës. Përkitazi, me faktet dhe rrethanat në fjalë, gjykata e shkallës së parë, ka marrë parasysh edhe deklaratat e disa nga të dëmtuarit që deklarojnë se shumata e parave në fjalë, i kanë ndarë nën ndikimin e të akuzuarës – pra, sipas urdhrit të sajë, mirëpo, deklaratave në fjalë nuk iu ka falur besimin, ngase, përveç deklaratave të këtyre të dëmtuarve me asnjë provë tjetër materiale në shkresat e lëndës, nuk është vërtetuar një gjë e tillë, prandaj, duke marrë parasysh deklaratat e të dëmtuarve tjerë, që deklarojnë se vetë personalisht me dëshirën e tyre kanë ndarë shumata të caktuara të parave për personat që kanë mbetur pa punë, dhe atë pa ndikimin e askujt e as të akuzuarës, se pagat i kanë marrë rregullisht në shumata të plota përmes llogarive bankare dhe se nga Departamenti Komunal për Arsim nuk ka pasur kurrfarë urdhërese me shkrim që të dëmtuarit të ndajnë shumata në fjalë, atëherë, rezulton se e akuzuara me kurrfarë veprimi konkret inkriminues nuk ka ndikuar në ndarjen e shumave të caktuara të parave për personat tjerë, për çka edhe gjykata e shkallës së parë, bazuar në provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ka konstatuar se nuk është vërtetuar se e akuzuara ka keqpërdorur pozitën e saj zyrtare duke ndikuar në të dëmtuarit që për personat tjerë të cilat kanë mbetur pa punë, të ndahet shumata e caktuar e parave nga pagat e tyre.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duke pasur parasysh rrethanat e cekura më lartë, gjegjësisht faktet jo kontestuese, që u cekën më lartë, pastaj se me asnjë fakt apo rrethanë nuk vërtetohet se e akuzuara me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm apo të shkakimit të dëmit personave të tjerë të ketë ndikuar drejtë për së drejti tek të dëmtuarit që të ndajnë shumata të caktuara të parave nga pagat e tyre, e duke e shpërdoruar kështu detyrën e saj zyrtare apo duke tejkaluar kompetencat, atëherë konkludimi i gjykatës së shkallës së parë, se në veprimet e të akuzuarës V.J., nuk përmbushen elementet e veprës penale, keqpërdorimi i detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPK, është i drejtë dhe i logjikshëm që do të thotë se drejt është aplikuar edhe Ligji Penal, dhe nuk ka shkelje të Ligjit Penal, në favor të akuzuarës, sikur që pretendohet në ankesë.

Prandaj, duke pasur parasysh atë që u tha më lartë, kjo gjykatë vlerëson se me të drejtë gjykata e shkallës së parë, ka konstatuar se me provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor, nuk është vërtetuar se e akuzuara ka kryer veprën penale keqpërdorimi i detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar e nga neni 422 par.1 të KPK, ngase përveç, pretendimeve në aktakuzë, se e akuzuara ka keqpërdorë pozitën e saj zyrtare me qëllim që personave të tjerë t'iu sjellë pasurim të kundërligjshëm, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar e duke i detyruar kështu, të dëmtuarit që nga pagat e tyre të ndajnë shuma të caktuara për personat tjerë, përkitazi me faktet dhe rrethanat në fjalë, me asnjë provë në shkresa të lëndës por as tani me ankesë, prokuroria nuk ka ofruar asnjë provë që do të argumentonte shpërdorimin, gjegjësisht, keqpërdorimin nga e akuzuara me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm apo shkaktimin të dëmit të personit tjetër, atëherë pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore, se e akuzuara është dashur të shpallet fajtor për këtë vepër penale, qartazi janë të pa bazuara e pa mbështetje në prova dhe në shkresa tjera të lëndës.

Nga çka u tha më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.528/2017, të dt.14.12.2017**

**Procesmbajtësi,**  
**Eroll Gashi**

**Anëtarët e kolegjit,**  
**1.Xhevdet Abazi**

**Kryetari i kolegjit,**  
**Fillim Skoro**

\_\_\_\_\_  
**2. Tonka Berishaj**  
\_\_\_\_\_